

1 PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

1.1 Hyrje

Mali Sharr është një masiv i madh malor i lartë, i cili shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në pjesën jugore të Kosovës, me një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 2500 km². Kjo zonë është e mbushur me vlera të larta natyrore, pyje, kullota, liqene malore, rrjedha ujore, një numër i madh i vlerave gjeomorfologjike dhe diversitet të pasur biologjik.

Një pjesë e Malit Sharr, që i përket Republikës së Maqedonisë së Veriut, është shpallur në kategorinë “Park Kombëtar” me Ligjin për shpalljen e Parkut Kombëtar Mali Sharr (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/2021).

Për shkak të kryerjes së detyrave për menaxhimin dhe mbrojtjen e parkut kombëtar, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut themeloi Institutin Publik Parku Kombëtar Mali Sharr (në tekstin e mëtejme: IPPK “Mali Sharr”), që do të menaxhojë parkun kombëtar bazuar mbi parimet e ekspertizës, kompetencës dhe në përputhje me rregulloret ligjore.

Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 67/04, 14/06, 84/07, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13, 41/14, 146/15, 39/16, 63/16, 113/18 dhe 18/19), Instituti Publik Parku Kombëtar Mali Sharr, pas pëlqimit paraprak nga organi i administratës shtetërore për kryerjen e punëve nga fusha e mbrojtjes së natyrës, miraton Planin për menaxhimin e zonës së mbrojtur për një periudhë 10 vjeçare, më së voni prej dy vjetësh nga dita e shpalljes së zonës së mbrojtur.

Baza ligjore për përgatitjen dhe miratimin e Planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura rrjedh nga paragrafi 1, neni 98 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, në përputhje me të cilin autoritetet përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve të menaxhimit dhe mbrojtjes së zonave të mbrojtura, miratojnë Plane të menaxhimit dhe programe vjetore për mbrojtjen e natyrës. Në bazë të paragrafit 4 të nenit 98 të të njëjtit ligj, Planet e menaxhimit për zonat e mbrojtura miratohen nga autoriteti përgjegjës për kryerjen e punëve të menaxhimit dhe mbrojtjes, në përputhje me aktin e shpalljes, pas pëlqimit të marrë më parë nga organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Në bazë të asaj që u përmend më lart, dhe fillimisht duke u nisur nga obligimet e nenit 98 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, IPPK “Mali Sharr” zhvilloi aktivitete për përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar.

Në Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar janë përcaktuar programe dhe aktivitete të veçanta për mbrojtjen e vlerave karakteristike natyrore dhe gjendjen origjinale në të cilën gjenden ato, për shkak të së cilës fiton statusin e trashëgimisë natyrore, si dhe pjesë që i referohet planifikimit dhe menaxhimit të hapësirës së parkut kombëtar.

Direktiva për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit Jetësor (2001/42/EC) dhe Ligji për Mjedisin Jetësor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16, 99/18, 89/22), përcaktojnë se plane, programe dhe strategji të caktuara, të cilat ka të ngjarë të kenë një ndikim të rëndësishëm në mjedisin jetësor, duhet të jenë lëndë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM).

1.2 Hyrje në Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces sistematik në të cilin merren parasysh masa të caktuara parandaluese, të cilat mundësojnë mbrojtjen e mjedisit jetësor nga të gjitha aspektet e mundshme, në procesin e planifikimit apo miratimit të vendimeve në nivel të “veprimeve strategjike” apo politikave, planeve dhe programeve. Është një mjet që do të duhet të përmirësojë cilësinë e përgjithshme të planifikimit dhe programimit të aktiviteteve të ardhshme duke pranuar konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm. Komponentët e VSM-së, veçanërisht qëllimet e tij janë të ndryshme, por në këtë dekadë rekomandohet dhe pritet që ndryshimet klimatike dhe diversiteti biologjik janë dy komponentë të fortë që duhet të kenë prioritet në përdorimin e tokës dhe planifikimin hapësinor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

1.2.1 Qëllimet e Vlerësimit Strategjik Mjedisor

Qëllimet kryesore të VSM-së janë:

- Të sigurojë mekanizëm për identifikimin, përshkrimin, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve/efekteve të dokumentit të planifikimit në mjedisin jetësor;
- Autoritetet përgjegjëse (miratuesit e dokumentit të planifikimit) të përgatisin raport mbi ndikimet e mundshme të rëndësishme të dokumentit të planifikimit në mjedisin jetësor dhe një analizë të alternativave reale;
- Të parandalohen, reduktohen dhe neutralizohen ndikimet negative në mjedisin jetësor. Rritja e ndikimeve pozitive mund të jetë gjithashtu përfitim i procesit të VSM-së;
- Të sigurojë konsultime dhe angazhim më të gjerë të palëve të interesuara, organeve të tjera përgjegjëse, autoriteteve dhe publikut në fazën e hershme dhe efektive të përgatitjes së dokumentit të planifikimit;
- Të sigurojë mendim nga publiku (raportet e konsultimit publik) që do të tregojë se si rezultatet e vlerësimit të mjedisit jetësor dhe mendimet e paraqitura gjatë procedurës së VSM-së janë marrë parasysh në versionin përfundimtar të dokumentit të planifikimit;
- Të sigurojë monitorimin e ndikimeve të rëndësishme mjedisore nga zbatimi i dokumentit të planifikimit nga autoritetet kompetente, duke siguruar kështu identifikimin e ndikimeve negative të paparashikuara në fazën e hershme të zbatimit të dokumentit të planifikimit dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes, kur është e nevojshme.

1.2.2 Korniza ligjore që rregullon procedurën e VSM-së

Procedura për kryerjen e Vlerësimit Strategjik të Mjedisit Jetësor është përcaktuar në **kapitullin X të Ligjit për Mjedisin Jetësor** (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16, 99/18 dhe 89/22).

Aktet nënligjore që rregullojnë procedurën e VSM-së janë:

- Dekret për strategjitë dhe programet, duke përfshirë ndryshimet e strategjive, planeve dhe programeve, për të cilat duhet të zbatohet procedurë për vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 153/07 dhe 45/11);
- Dekret për kriteret në bazë të të cilëve miratohen vendimet nëse dokumentet e caktuara të planifikimit mund të kenë ndikim të rëndësishëm në mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 144/07);

- Dekret për përmbajtjen e raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 153/07);
- Dekret për pjesëmarrjen e publikut në hartimin e rregulloreve dhe akteve tjera, si dhe planeve dhe programeve nga fusha e mjedisit jetësor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 147/08 dhe 45/11);
- Rregullore për formën, përmbajtjen dhe shabllonin e Vendimit për zbatimin, përkatësisht moszbatimin e Vlerësimit Strategjik dhe formularët për nevojën e zbatimit, përkatësisht moszbatimin e vlerësimit strategjik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 122/11).

1.2.3 Integrimi i procedurave për përgatitjen e dokumentit të planifikimit dhe VSM-së

Procedura e VSM-së është zbatuar në mënyrë paralele me procedurën për përmirësimin e Draft-Planit të Menaxhimit me PK “Mali Sharr”. Integrimi i dy proceseve u arrit përmes bashkëpunimit të ngushtë të ekipeve të projektit (VSM dhe Plani i Menaxhimit të PK “Mali Sharr”) dhe pjesëmarrësve kryesorë, përmes rishikimit të literaturës, takimeve, etj.

1.2.4 Përcaktimi i nevojës dhe vëllimit të VSM-së dhe pjesëmarrjes së publikut

Duke marrë parasysh bazën për miratimin e Planit të Menaxhimit të PK “Mali Sharr” dhe llojin e dokumentit, u vendos që të përcaktohet nevoja për zbatimin e VSM-së.

Pas fazës së përcaktimit të nevojës për zbatimin e VSM-së, vijonte faza e përgatitjes së Vendimit për zbatimin e VSM-së dhe dokumentacionit shoqërues, në bazë të të cilit MMJPH solli Mendimin për pranimin e Vendimit për zbatimin e VSM-së sipas dokumentit të planifikimit dhe përcaktimin e vëllimit të VSM-së (nr. PA1-15-746/2022, më datë 26.04.2022). Në përputhje me kërkesat ligjore, procedura e VSM-së fillon me përgatitjen e Formularëve dhe Vendimit për zbatimin e VSM-së, procedurë në të cilën përfshihen autoritetet e interesuara.

Në fazën e përcaktimit të nevojës për zbatimin e VSM-së, u identifikuan organet e prekura nga zbatimi i Planit të Menaxhimit të PK “Mali Sharr”. Në drejtim të përcaktimit të vëllimit të VSM-së, janë mbajtur disa takime me përfaqësues të IPPK “Mali Sharr”, MMJPH-së dhe përfaqësues të autoriteteve/palëve të interesuara.

Në këto takime u përcaktuan çështjet kryesore mjedisore, qëllimet dhe treguesit që do të mbulohen nga Raporti i VSM-së.

1.3 Përmbledhje/pasqyrë e shkurtër e përmbajtjes, qëllimet kryesore të dokumentit të planifikimit dhe lidhjes me planet dhe programet e tjera përkatëse/dokumentet e planifikimit

1.3.1 Pasqyrë e shkurtër e përmbajtjes së Planit

Mali Sharr është një masiv i lartë malor, i cili shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në pjesën jugore të Kosovës. Brenda kufijve të saj natyrorë mbulon një sipërfaqe prej 2 480 km², nga të cilat 881 km² ose 35.5 % i përkasin Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pjesa maqedonase e Malit Sharr i përket shtatë komunave: Jegunovcë, Tearcë, Tetovë, Vrapçishtë, Bogovinë, Gostivar, Mavrovë dhe Rostushë. Pjesa më e madhe gjendet në Komunën e Tetovës (220 km²), ndërsa pjesa më e vogël (26,4 km²) në Mavrovë dhe Rostushë. Kjo zonë është e mbushur me vlera natyrore.

Republika e Maqedonisë së Veriut kërkoi nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Jetësor (UNEP) të mbështesë iniciativën për shpalljen e Malit Sharr për zonë të mbrojtur, në

kategorinë “Park Kombëtar”. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 30 qershor 2021, solli vendim që një pjesë e Malit Sharr të shpallet për Park Kombëtar.

Në përputhje me Ligjin për shpalljen e një pjese të Malit Sharr për park kombëtar, një vit pas miratimit të Ligjit ¹ (6 korrik 2021), duhet të miratohet Plani i Menaxhimit nga Instituti Publik që menaxhon zonën e mbrojtur. Për këtë qëllim është përgatitur Draft-Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar “Mali Sharr”.

Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar “Mali Sharr” është përgatitur dhe zbatuar sipas dy studimeve të përgatitura më parë: Studimi i Valorizimit të Malit Sharr (2020) dhe Studimi Socio-Ekonomik për parkun kombëtar të propozuar të Malit Sharr (2020). Studimet u përgatitën nga një ekip shumëdisiplinor i ekspertëve dhe me pjesëmarrjen e MMJPH-së dhe UNEP-it. Ky plan përcakton masat dhe aktivitetet për mbrojtjen e vlerave karakteristike natyrore në park, si dhe planifikimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të tij.

Sipërfaqja e përgjithshme e Parkut Kombëtar “Mali Sharr” është 62,705 ha. Kufijtë e parkut janë saktësuar në detaje në Ligjin për shpalljen e Parkut Kombëtar, që është miratuar më 7 korrik 2021 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21).

Toka e cila gjendet brenda kufijve të PK “Mali Sharr” është në pronësi shtetërore dhe private. Pjesa më e madhe e tokës në parkun kombëtar është në pronësi të shtetit dhe jepet me koncesion, veçanërisht kullotat, vendet e peshkimit, gjuetitë, miniera sipërfaqësore për nxjerrjen e burimeve minerale, si dhe hidrocentrale të vogla.

Pyjet janë në pronësi shtetërore dhe private. Me pyjet të cilat janë në pronësi shtetërore menaxhojnë subjekte të cilët janë të emëruar nga Qeveria (autoriteti për menaxhimin e parkut kombëtar). Me pyjet që janë në pronësi private menaxhojnë pronarët e tyre, në bazë të kriterëve të përcaktuara dhe planeve të menaxhimit të miratuara.

1.3.2 Kufijtë e propozuar të zonimit

Kufijtë e propozuar të zonimit janë:

➤ Zona e mbrojtjes së rreptë

Zona e mbrojtjes së rreptë (ZMRR) është e ndarë në 5 njësi të veçanta dhe atë: Luboten, Bisticë, Kobilicë, Leshnicë dhe Mazdraçë. Sipërfaqja e përgjithshme e zonës së mbrojtjes së rreptë e parkut kombëtar “Mali Sharr” është 16 651 ha ose 26.56% e sipërfaqes së përgjithshme të parkut.

➤ Zona e menaxhimit aktiv

Zona e menaxhimit aktiv mbulon një sipërfaqe prej 30 763 ha ose 49,06% të sipërfaqes së përgjithshme të parkut.

➤ Zona për përdorim të qëndrueshëm

Zona e përdorimit të qëndrueshëm mbulon një sipërfaqe prej 13 805 ha ose 22.02% të sipërfaqes së përgjithshme të parkut.

➤ Ripi mbrojtës rreth qendrës së skijimit Kodra e Diellit

Ripi mbrojtës mbulon një sipërfaqe prej 1 484 ha ose 2.37% të sipërfaqes së përgjithshme të parkut.

Qëllimi i zonimit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura është sigurimi i kushteve të nevojshme për ruajtjen e proceseve ekologjike dhe biodiversitetit, përmes ruajtjes së përhershme të rajoneve përfaqësuese fiziko-gjeografike, bashkësive mjedisore, burimeve gjenetike dhe specieve në kushte natyrore; krijimi i kushteve për zhvillimin e turizmit në

¹ (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 151/21)

përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe realizimin e qëllimeve kulturore, shkencore, arsimore dhe rekreative, që njëkohësisht ruan gjendjen natyrore të zonës.

Në këtë kuptim, janë të ndaluara aktivitetet që kërcënojnë vlerat natyrore të parkut kombëtar. Lejohen aktivitete turistike dhe rekreative dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, në mënyrë që të mos i kërcënojë habitatet, speciet dhe ekuilibrin e tyre natyror.

1.3.3 Programet e menaxhimit dhe plani operativ

Baza e Draft-Planit të Menaxhimit janë 8 programe me nënprograme dhe aktivitete të detajuara në një plan operativ pesëvjeçar. Për çdo nënprogram janë përcaktuar aktivitetet e detajuara, niveli i prioritetit, treguesit, bartësit e aktivitetit, burimet e mundshme të financimit dhe niveli i rëndësisë së mbështetjes së jashtme.

Në përputhje me detyrimet ligjore, Plani tregon aktivitetet të cilat IPPK “Mali Sharr” është përgjegjës për zbatimin në periudhën e pare pesëvjeçare (2021-2026). Pas kësaj periudhe, Instituti Publik do të kryejë auditim në Planin e Menaxhimit. Aktivitetet janë organizuar në tetë Programe, të krijuar me qëllim të përmbushjes së objektivave të identifikuara për ruajtjen e zonës së mbrojtur.

Sipas planit pesëvjeçar për zbatimin e programeve të menaxhimit të PK “Mali Sharr”, në vazhdimësi është paraqitur numri i nënprogrameve dhe aktiviteteve për secilin program.

- ✓ **Programi 1 – Ruajtja dhe monitorimi i trashëgimisë natyrore:** si pjesë e këtij programi janë zhvilluar shtatë nënprograme që përfshijnë 23 aktivitete;
- ✓ **Programi 2 – Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore:** si pjesë e këtij programi janë zhvilluar shtatë nënprograme që përfshijnë 31 aktivitete;
- ✓ **Programi 3 – Menaxhimi i habitateve dhe ekosistemeve:** si pjesë e këtij programi janë zhvilluar 5 nënprograme që përfshijnë 20 aktivitete;
- ✓ **Programi 4 – Programi për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore:** si pjesë e këtij programi janë zhvilluar 5 nënprograme që përfshijnë 5 aktivitete;
- ✓ **Programi 5 – Programi për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm:** si pjesë e këtij programi janë zhvilluar 4 nënprograme që përfshijnë 27 aktivitete;
- ✓ **Programi 6 – Programi për zhvillim lokal:** si pjesë e këtij programi janë zhvilluar 4 nënprograme që përfshijnë 22 aktivitete;
- ✓ **Programi 7 – Programi për informim, ndërgjegjësimin e publikut dhe edukim:** si pjesë e këtij programi janë zhvilluar 3 nënprograme që përfshijnë 10 aktivitete;
- ✓ **Programi 8 – Programi për menaxhim, organizim të punës dhe financim:** si pjesë e këtij programi janë zhvilluar 5 nënprograme që përfshijnë 22 aktivitete.

1.3.4 Korelacioni i qëllimeve të dokumentit të planifikimit me planet, programet/dokumentet e tjera përkatëse të planifikimit

Akti themelor juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili rregullon mbrojtjen e natyrës dhe ruajtjen e diversitetit biologjik dhe peizazhit, është Ligji për Mbrojtjen e Natyrës. Me këtë ligj përcaktohen kategoritë e zonave të mbrojtura, mënyra e menaxhimit dhe dokumentet bazë për menaxhimin e zonave të mbrojtura.

Hartimi i Planit të Menaxhimit është dokument i cili përcakton kushtet për realizimin e interesave kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e planifikimit, në fushën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerave të veçanta natyrore, vlerave të rëndësishme natyrore, si dhe rregullimin dhe përdorimin e tyre në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në Planin e Menaxhimit të PK “Mali Sharr” janë:

- Të ruajë, përmirësojë dhe monitorojë vlerat natyrore, duke përfshirë edhe speciet e egra, habitatet dhe ekosistemet, veçoritë fizike (gjeologjike, gjeomorfologjike, pedologjike dhe hidrologjike) dhe peizazhet;
- Të sigurojë një mënyrë të qëndrueshme të përdorimit të burimeve natyrore. Përdorimi i tyre siguron të ardhura për bashkësitë lokale dhe kontribuon në financimin e institucioneve publike në parkun kombëtar;
- Të sigurojë që menaxhimi i habitateve dhe ekosistemeve është në përputhje me qëllimet e mbrojtjes të vendosura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Të mbrojë dhe promovojë diversitetin e peizazheve dhe trashëgimisë kulturore të parkut, duke përfshirë lloje të ndryshme peizazhesh akullnajore dhe lloje të peizazheve tradicionale që janë zhvilluar gjatë shekujve përmes ndërveprimit të njerëzve me natyrën;
- Mali Sharr do të mirëpresë turistë nga e gjithë bota të cilët do të njohin dhe shijojnë bukurinë dhe diversitetin e zonës. Vizitorët kontribuojnë në financimin e parkut kombëtar përmes pagesës së tarifave turistike, ndërsa eko-turizmi gjeneron të ardhura për popullsinë vendase që është e përfshirë në mënyrë aktive në menaxhimin e tyre, akomodimin dhe përgatitjen e ushqimit tradicional;
- Menaxhimi i parkut kombëtar do të mbështesë në mënyrë aktive zhvillimin e qëndrueshëm të fshatrave malore;
- Të sigurojë informacion dhe të rritet ndërgjegjësimi për vlerat natyrore dhe kulturore, qëllimet e zonimit të zonave të mbrojtura, kufizimet dhe masat për mbrojtje, si dhe për përfitimet që parku kombëtar mundëson për popullsinë vendase. Për më tepër, të ofrojë aktivitete edukative për të gjithë vizitorët dhe grupet e synuara në mënyrë që të i shijojnë dhe përjetojnë vlerat e parkut kombëtar;
- Të zbatojë menaxhim efikas, planifikim, zhvillim strategjik dhe kapacitete të forta që do të sigurojnë burime financiare të përhershme dhe të qëndrueshme.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë hartuar një sërë dokumentesh strategjike dhe planifikuese kombëtare, rajonale dhe lokale të cilat janë të fokusuara kryesisht në çështjen e mbrojtjes së mjedisit jetësor, natyrës dhe diversitetit biologjik, përveç të tjerave edhe në zonën ku ndodhet parku kombëtar.

Në Raport është dhënë korelacioni (harmonizim/mos-harmonizim) i qëllimeve për zhvillim dhe qëllimeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor me dokumentet ekzistuese strategjike dhe planifikuese kombëtare, rajonale dhe vendose me qëllimet dhe aktivitetet e Planit të Menaxhimit të PK “Mali Sharr”.

Me harmonizim të qëllimeve kuptojmë se zbatimi i qëllimeve dhe aktiviteteve të parashikuara në Plan do të kontribuojë në arritjen e qëllimeve të dokumenteve strategjike dhe planifikuese tashmë të miratuara.

Mos-harmonizimi i qëllimeve – kuptojmë se zbatimi i një pjese të qëllimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara në Plan, për shkak të natyrës dhe trendeve për zhvillim, nuk mund të harmonizohet plotësisht në nivelin e dokumentit strategjik, por do të arrihet në një nivel më të ulët në procesin e zbatimit të Planit, në nivel të dokumentacionit të planifikimit / projektit.

1.4 Aspekte relevante për gjendjen aktuale në mjedisin jetësor

Në këtë kapitull në Raport janë paraqitur aspektet relevante të gjendjes aktuale të mjedisit jetësor në nivel rajonal, si dhe gjendjet në parkun kombëtar “Mali Sharr”, nga pikëpamja demografike, zhvillimi ekonomik, turizmi, shëndeti i popullsisë, karakteristikat klimatike dhe cilësia e ajrit, ndryshimet klimatike, gjendja e zhurms, ujërave (hidrologjia, cilësia e ujërave), toka, kullotat, pyjet dhe tokat pyjore, diversiteti biologjik, trashëgimia natyrore, diversiteti i peizazhit, trashëgimia kulturore, gjendja

e të mirave materiale (menaxhimi i mbeturinave, furnizimi me ujë, menaxhimi i ujërave të zeza, furnizimi me energji), fatkeqësitë natyrore etj.

1.5 Karakteristikat e mjedisit jetësor në zonat që do të prekeshin ndjeshëm dhe gjendja pa zbatimin e Planit

Në këtë kapitull në Raport janë paraqitur gjendja, trendet dhe kërcënimet mbi popullsinë dhe shëndetin e njerëzve, ajri, ndryshimet klimatike, ujërat, tokat, diversiteti biologjik dhe trashëgimia natyrore, trashëgimia kulturore, peizazhi, të mirat materiale, si dhe gjendja pa zbatimin e Planit.

Bazuar në analizat e gjendjeve, trendeve dhe kërcënimeve, lidhur me përdorimin dhe rregullimin e hapësirës, mediumet nga mjedisi jetësor, si dhe zhvillimi socio-ekonomik në rajon, pa zbatimin e Planit të Menaxhimit të PK “Mali Sharr” do të mbesin në nivel aktual, si rezultat i:

- Mungesa e menaxhimit të planifikuar të zonës së mbrojtur në lidhje me zonat e përcaktuara mbrojtëse;
- Mospërmbushja e kërkesave në nivel kombëtar dhe kërkesave të BE-së për mbrojtjen e vlerave dhe rariteve natyrore, si dhe diversitetit biologjik;
- Mos-harmonizimi i interesave kombëtare, rajonale dhe lokale për zhvillim ekonomik dhe të biznesit me qëllimet e zhvillimit të zonës së mbrojtur;
- Mos-harmonizimi i dokumenteve të planifikimit dhe sektoriale të miratuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut për sa i përket shfrytëzimit të hapësirës, mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe zhvillimit socio-ekonomik;
- Zhvillim jo i harmonizuar i infrastrukturës në përputhje me qëllimin e tokës në parkun kombëtar dhe zonat mbrojtëse;
- Masat dhe aktivitetet e papërcaktuara për planifikimin hapësinor, shfrytëzimin e burimeve, mbrojtjen e mjedisit jetësor, trashëgiminë natyrore dhe zhvillimin socio-ekonomik;
- Kompetenca dhe përgjegjësi të pacaktuara për zbatimin e masave dhe aktiviteteteve;
- Specie dhe habitatet e rëndësishme do të ishin nën presion të fortë antropogjenik;
- Pamundësia e shfrytëzimit të mundësive turistike që ofron kjo zonë;
- Mungesa e Planit të Menaxhimit të zonës, me qëllim mbrojtjen e vlerave natyrore etj.

1.6 Zonat me rëndësi të veçantë për mjedisin jetësor në aspekt të mbrojtjes së shpendëve të egër dhe habitateve

Parku kombëtar “Mali Sharr” ose pjesë të territorit të tij, në bazë të kriterëve dhe standardeve ndërkombëtare, identifikohet si:

- Zonë Emerald.** Për shkak të vlerave të larta natyrore, Mali Sharr është njohur prej kohësh në disa nisma globale. Sipërfaqja e zonës Emerald “Mali Sharr” është 47,003.6 ha.
- Në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e Natura 2000” – Mali Sharr u propozua si zonë potenciale e ardhshme **Natura 2000**, me nevojën për kërkime shtesë. Hulumtimet e fundit kanë konfirmuar vlerat e Malit Sharr në drejtim të vendosjes së një zone të ardhshme Natura 2000.
- Zonë e rëndësishme e shpendëve:** Mali Sharr është përcaktuar si zonë e rëndësishme e shpendëve. Zona e rëndësishme e shpendëve “Mali Sharr” mbulon pjesët jugore dhe qendrore të Mali Sharr dhe shtrihet në sipërfaqe prej 41,317 ha.
- Zonë e rëndësishme e bimëve “Mali Sharr”:** Zona e rëndësishme e bimëve Mali Sharr mbulon një sipërfaqe prej 50,163.19 ha. Zë një sipërfaqe të madhe të kullotave malore

dhe ato të larta mbi nënshtresa gëlqerore dhe silikate. Pyjet më të përhapura janë pyjet e ahut dhe bredhit. Zona e rëndësishme e bimëve përfshin 16 lloje.

- e. **Zonë e rëndësishme për fluturat “Mali Sharr”:** Mali Sharr është identifikuar si zonë e rëndësishme për fluturat dhe u emërua zyrtarisht në vitin 2003. Sipërfaqja e zonës është 68,084.62 ha.
- f. **Brezi i Gjelibër Evropian:** Masivi i Malit Sharr është një nga zonat më të rëndësishme të Brezit të Gjelibër Ballkanik. Ky rajon është një nga strehimoret e fundit të mbetura për mishngrënësit e mëdhenj evropianë, siç janë: ujku, ariu dhe rrëqebulli. Mali Sharr shtrihet nga pjesa jugore e Kosovës dhe pjesa veriperëndimore e Maqedonisë së Veriut deri në Shqipërinë verilindore. Ky masiv malor është rreth 80km i gjatë dhe 10 deri në 30 km i gjerë. Masivi i Malit Sharr shtrihet deri në malin Korab (2,764m) në jugperëndim, përpara se të vazhdojë përgjatë kufirit shqiptaro-maqedonas si vargmali i Deshatit.

1.7 Qëllimet e mbrojtjes së mjedisit jetësor, të përcaktuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Një nga sfidat më të mëdha për politikën e mjedisit jetësor është arritja e një ekuilibri në mes dimensioneve ekonomike dhe sociale të zhvillimit, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor nga ana tjetër, që parashikon rritjen e përdorimit të instrumenteve ekonomike në drejtim të mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Parimet bazë për mbrojtjen e mjedisit jetësor në vend janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Një nga konventat kryesore ndërkombëtare, në të cilët Republika e Maqedonisë së Veriut është nënshkruese, është Konventa për Diversitet Biologjik, e ratifikuar dhe e publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”nr. 54/97. Gjithashtu, Republika e Maqedonisë së Veriut ka ratifikuar një numër të madh konventash dhe protokolle për mbrojtjen e diversitetit biologjik, peizazhit, trashëgimisë kulturore, ndryshimeve klimatike, vlerësimit të ndikimit mjedisor në një kontekst ndërkufitar, qasje në informacion, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje dhe mbrojtja ligjore për çështje mjedisore, vlerësimi strategjik i mjedisit jetësor etj.

1.7.1 Qëllimet e Vlerësimit Strategjik Mjedisor

Qëllimet e mbrojtjes së mjedisit jetësor shprehen përmes qëllimeve të vlerësimit strategjik mjedisor dhe të njëjtit tregohen përmes gjendjes së: popullsisë dhe shëndetit të njerëzve, diversitetit biologjik, ujit, tokës, ajrit, ndryshimeve klimatike, të mirave materiale, peizazhit, trashëgimisë kulturore dhe ndërveprimit ndërmjet tyre.

Në Raport janë paraqitur qëllimet e VSM-së lidhur me qëllimet e përcaktuara në Planin e Menaxhimit të PK “Mali Sharr” (pajtueshmëria dhe mos-pajtueshmëria e tyre). Pajtueshmëria/mos-pajtueshmëria e qëllimeve është shqyrtuar lidhur me Planin e Menaxhimit të PK “Mali Sharr” (objektivat për qëllimin e hapësirës dhe aktivitetet për arritjen e tyre) dhe në lidhje me zbatimin e tij në të ardhmen në një nivel më të ulët të dokumenteve të planifikimit ose dokumentacionin e projektit.

1.8 Analiza e alternativave

Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar “Mali Sharr” është përgatitur në periudhën 2022-2031 dhe përmban qëllime nga të cilat rrjedhin programe/nënprograme dhe aktivitete që duhet të realizohen në atë periudhë. Në këtë Plan nuk janë shqyrtuar zgjidhje alternative për aktivitetet e planifikuara, me të cilat planifikohet mbrojtja e vlerave natyrore në park,

gjegjësisht aktivitetet e propozuara bazohen në nevojat e përcaktuara për mbrojtje në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore. Të njëjtit synojnë funksionimin e ardhshëm të PK “Mali Sharr” duke u bazuar në mundësitë, potencialet dhe burimet e disponueshme, me qëllim të plotësimit të nevojave dhe kërkesave në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Si rezultat i kësaj, në këtë kapitull shqyrtohen dy alternativa, pra gjendja pa dhe me zbatimin e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar “Mali Sharr”. Alternativa e shqyrtuar për zbatimin e Planit të Menaxhimit me PK “Mali Sharr” është alternativë e pranueshme.

1.9 Ndikimet e mundshme të rëndësishme mjedisore dhe masat për reduktim

Ndikimet e mundshme në mjedisin jetësor dhe në aspektet sociale, që mund të shkaktohen me zbatimin e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar “Mali Sharr”, do të rrjedhin nga zbatimi i aktiviteteve të planifikuara të menaxhimit të përfshira në programet/nënprogramet, me të cilat duhet të arrihet mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe zhvillim i qëndrueshëm, si dhe përmbushja e qëllimeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Ndikimet shqyrtohen në aspekt të ndikimeve negative dhe të përfitimeve të ardhshme, veçanërisht ndikimet pozitive. Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor merr parasysh ndikimet në të gjitha mediumet dhe gjendjet e mjedisit jetësor si dhe përfitimet socio-ekonomike, por nga një aspekt i përgjithshëm.

Është evidente se zbatimi i aktiviteteve do të kontribuojë në reduktimin e kërcënimeve dhe përmirësimin e gjendjes së diversitetit biologjik dhe trashëgimisë kulturore, përmirësimi i gjendjes ekzistuese të medimeve dhe fushave në mjedisin jetësor dhe social. Por, edhe zhvillimi i ardhshëm i Parkut Kombëtar do të kontribuojë në shfaqjen e gjendjeve të reja, burimeve të mundshme të emetimeve dhe kërcënimeve për mjedisin jetësor dhe social.

Për një pjesë të aktiviteteve të planifikuara në Plan, do të kryhet një procedurë shtesë për një vlerësim më të detajuar të ndikimeve mjedisore në raportet e vlerësimit strategjik në nivel të dokumentacionit specifik të planifikimit ose në nivel projekti përmes studimeve të vlerësimit të ndikimit mjedisor ose elaboreve për mbrojtjen e mjedisit jetësor për çdo projekt/objekt veçmas.

Ndikimet në medime specifike nga aspekti mjedisor dhe socio-ekonomik do të eliminohen ose përmirësohen efektivisht, nëse gjatë zbatimit të Planit dhe aktiviteteve të propozuara, nga të cilat shtesë do të rezultojnë projekte të veçanta, do të merren parasysh masa për reduktimin e ndikimeve, të përcaktuara në Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, si dhe masat që do të jepen në raportet individuale të VSM-së në nivel të dokumentacionit të planifikimit të një rangu më të ulët ose në nivel projektsh, nëpërmjet studimeve të vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor ose elaboreve për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

1.10 Plani për monitorimin e zbatimit të Planit nga aspekti mjedisor

Vlerësimi Strategjik Mjedisor përfshin monitorimin mbi realizimin e Planit të Menaxhimit të PK “Mali Sharr” dhe të gjitha ndikimet e rëndësishme pozitive dhe negative të identifikuara, të cilët do të rezultojnë nga realizimi i aktiviteteve të parashikuara në planin operativ, që duhet të realizohet në periudhën 2022-2026.

Plani i monitorimit ofron një mundësi për vëzhgim, hulumtim dhe vlerësim sistematik të gjendjes në mediumet dhe fushat e mjedisit jetësor dhe të aspekteve socio-ekonomike.

Plani mundëson vendosjen e një lidhje ndërvepruese në mes të gjitha palëve të përfshira dhe paraqet një bazë për institucionet kompetente dhe palët e interesuara të kontrollojnë procesin e zbatimit të legjislacionit dhe të sjellin vendime të duhura.

Me qëllim të kryerjes së monitorimit mbi efektivitetin e Planit, është e nevojshme të monitorohen treguesit e përcaktuar dhe zhvillimi i tyre, duke pasur parasysh të dhënat për gjendjen aktuale të mjedisit jetësor.

Me monitorimin e gjendjes së mjedisit jetësor do të vërtetohet arsyetimi dhe aplikimi i masave zbutëse të propozuara dhe funksionaliteti i tyre, që paraqet një përfitim të madh lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor.

1.11 Konkluzione dhe rekomandime

1.11.1 Konkluzione

- Mali Sharr është një masiv i madh malor i lartë, që shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në pjesën jugore të Kosovës, me një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 2 500 km². Kjo zonë është e mbushur me vlera të larta natyrore, pyje, kullota, liqene malore, rrjedha ujore, një numër të madh të vlerave gjeomorfologjike dhe diversitet të pasur biologjik.
- Një pjesë e Malit Sharr që i përket Republikës së Maqedonisë së Veriut, është shpallur në kategorinë “Park Kombëtar” me Ligjin për shpalljen e Parkut Kombëtar Mali Sharr (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/2021).
- Sipërfaqja e përgjithshme e PK “Mali Sharr” është 62 705 ha. Kufijtë e parkut janë të përcaktuar në detaje në Ligjin për shpalljen e Parkut Kombëtar.
- Plani i Menaxhimit të PK “Mali Sharr” është përgatitur dhe realizuar sipas dy studimeve të përgatitura më parë: Studimi i Valorizimit të Malit Sharr (2020) dhe Studimi Socio-Ekonomik për Parkun Kombëtar të propozuar Mali Sharr (2020).
- Plani i menaxhimit paraqet një mjet për menaxhimin e zonës së mbrojtur dhe është një pasqyrë e gjendjes reale të vlerave natyrore bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të vlerave natyrore, kërcënimet me të cilat përballet zona, rëndësinë kombëtare dhe ndërkombëtare të zonës, vlerat socio-ekonomike, rekomandime për menaxhimin e zonës, dhe në veçanti një nga komponentët më kyç është propozimi i zonimit.
- Për shkak të kryerjes së punëve për menaxhimin dhe mbrojtjen e Parkut Kombëtar, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut krijoi Institutin Publik Parku Kombëtar Mali Sharr (në tekstin e mëtejshëm: IPPK “Mali Sharr”), që do të menaxhojë Parkun Kombëtar bazuar në parimet e ekspertizës, kompetencës dhe në përputhje me rregulloret ligjore.
- Në Planin e Menaxhimit të PK “Mali Sharr” janë paraqitur gjendjet ekzistuese, problemet, trendet dhe kërcënimet për të gjitha temat relevante të cilat në mënyrë metodologjike hyjnë në përmbajtjen e Planit.
- Baza e Planit të menaxhimit janë 8 programe me nënprograme dhe aktivitete të detajuara të përcaktuara në një plan operativ pesëvjeçar (2022-2026). Në secilin nënprogram të Planit janë përcaktuar aktivitete të detajuara për mbrojtjen e vlerave karakteristike natyrore dhe gjendjen origjinale në të cilën gjenden ato, për shkak të së cilës fiton statusin e trashëgimisë natyrore, si dhe një pjesë që i referohet planifikimit dhe menaxhimit të hapësirës së Parkut Kombëtar. Gjithashtu, për çdo aktivitet përcaktohet niveli i prioritetit, treguesit, bartësit e aktivitetit, burimet e mundshme për financimin dhe niveli i rëndësisë së mbështetjes së jashtme.
- Plani përfshin programe dhe nënprograme për arritjen e qëllimeve të veçanta të mbrojtjes përmes aktiviteteve të shumta, me të cilat duhet të sigurohet përmirësimi i gjendjes së trashëgimisë së përgjithshme natyrore, monitorimi i gjendjeve, inventarizimi, si dhe masa për përmirësimin e medimeve dhe fushave të mjedisit jetësor, të cilat do të kontribuojnë në

reduktimin e presioneve/kërcënimeve të identifikuar, veçanërisht mbrojtjen dhe përmirësimin e pasurisë natyrore.

- Plani parashikon aktivitete që duhet të sigurojnë informacione dhe të rritet ndërgjegjësimi për vlerat natyrore dhe kulturore, qëllimet e zonimit të zonave të mbrojtura, kufizimet dhe masat mbrojtëse, si dhe përfitimet që Parku Kombëtar u mundëson popullatës lokale dhe vizitorëve të tij.
- Me Planin parashikohet organizimi i aktiviteteve në territorin e PK “Mali Sharr” të sigurojë zbutjen ose eliminimin e ndikimit të presioneve indirekte dhe të drejtëpërdrejta, aktivitetet ekonomike të përshtaten dhe zhvillohen në mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen e diversitetit biologjik dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe shërbimeve të ekosistemit në park, pa paraqitur ndonjë kërcënim për zonën e mbrojtur.
- Në Planin e Menaxhimit të PK “Mali Sharr” parashikohet organizim i hapësirës, mbrojtja e trashëgimisë natyrore, shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve, përmirësimin e infrastrukturës, aktivitete për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin rural, mjedisin jetësor, zhvillimi socio-ekonomik etj.
- Plani parashikon aktivitete për zhvillimin lokal, që do të kontribuojnë në pjesëmarrjen aktive të popullsisë vendase në menaxhimin e Parkut dhe rritjen e përfitimeve ekonomike për bashkësinë lokale, përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në Parkun Kombëtar, zbatimi i së cilës do të kontribuojë në uljen e varfërisë dhe përjashtimit social.
- Në këtë Plan janë dhënë udhëzime për zhvillimin e qëndrueshëm të Parkut Kombëtar, që duhet të merren parasysh gjatë përgatitjes së dokumentacionit të nivelit më të ulët për shfrytëzimin e hapësirës dhe tokës.
- Plani parashikon aktivitete që lidhen me mbrojtjen dhe menaxhimin, promovimin e vlerave natyrore, përmes inventarizimit, hartëzimit, monitorimit etj.
- Në Planin e Menaxhimit të PK “Mali Sharr” parashikohen masa për vendosjen e monitorimit me të cilin do të ndiqet gjendja e mediumeve në mjedisin jetësor, do të sigurohen të dhëna dhe disponueshmëria e tyre, që do të ndihmojë në proceset e ardhshme të planifikimit dhe përdorimit të hapësirës.

1.11.2 Rekomandime

- Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar “Mali Sharr”.
- Planifikimi dhe urbanizimi i territorit në park të kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në Planin e Menaxhimit, kërkesat e legjislacionit kombëtar për planifikimin hapësinor dhe urban dhe mbrojtja e mjedisit jetësor, përkatësisht të përgatitet një Plan Hapësinor për PK “Mali Sharr” për të cilin patjetër duhet të zbatohet procedurë për vlerësimin strategjik mjedisor.
- Sipërfaqet nën pyje dhe kullota nuk duhet të shndërrohen në tokë ndërtimore, si dhe toka bujqësore me klasë të bonitetit të lartë (nën kategorinë IV).
- Gjatë urbanizimit të ardhshëm të parkut, të shmangen lokacionet që disponojnë me një diversitet të pasur dhe të vlefshëm biologjik dhe gjeodiversitet, hyjnë në zona mbrojtëse të burimeve që ofrojnë ujë të pijshëm dhe për ujitje, si dhe zona të ndjeshme ndaj përmytjeve, erozionit dhe llojeve të tjera të degradimit të tokës.
- Ndërtimi/rindërtimi i infrastrukturës dhe objekteve të planifikuara duhet të kryhet në përputhje me kërkesat e Planit të Menaxhimit, legjislacionit kombëtar për planifikim urban, ndërtim, mbrojtja e mjedisit jetësor etj. Për çdo ndërtim/rindërtim të planifikuar, është e detyrueshme të kryhet procedurë për vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedisin jetësor, përdërisa funksionimi i tij duhet të kryhet në përputhje me kërkesat ligjore të dokumenteve

të përgatitura për vlerësimin e ndikimeve, si dhe kërkesat e ligjit për mjedisin jetësor dhe akteve nënligjore.

- Përfshirja aktive e të gjithë palëve të interesuara dhe transparencë në marrjen e vendimeve për përdorimin e tokës në të ardhmen, infrastrukturën e planifikuar në Park, si dhe për çdo aktivitet të parashikuar nga i cili ekziston mundësia që ato të preken drejtëpërdrejtë ose në mënyre indirekte.
- Shërbimet e ekosistemit duhet të kryhen në përputhje me masat e parashikuara në Plan, si dhe në përputhje me rregulloret ligjore.
- Zbatimi i masave për menaxhimin e duhur të mbeturinave nga aktivitetet bujqësore dhe blegtorale, me mbeturinat e vendeve më të vizituara turistike, veçanërisht vendosjen e kontejnerëve që do të mbrohen nga qasja e kafshëve, vandalizimi etj.
- Shfrytëzimi efikas i burimeve ujore, trajtimi i ujërave të zeza nga kopshtet apo qendrës së mbarështimit para derdhjes përfundimtare në marrës, si dhe grumbullimi dhe trajtimi i detyrueshëm i ujërave të zeza në stacionet e pastrimit në objektet turistike (ekzistuese dhe të ardhshme).
- Të gjitha format e turizmit duhet të zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të ndërjegjshme, lidhur me zonat e përcaktuara në Planin e Menaxhimit dhe rregullat/protokollet dhe ligjet e përcaktuara.
- Përdorimi i materialeve tradicionale të ndërtimit (guri, druri, bari i thatë dhe lumi) kurdoherë që është e mundur, gjatë rinovimit të objekteve në zonën e menaxhimit aktiv, përdorimi i materialeve tradicionale të ndërtimit është i detyrueshëm.
- Sigurimi i mendimeve nga organet kompetente, PK Mali Sharr dhe MMJPH, gjatë projektimit për rikonstruksionin e objekteve ekzistuese akomoduese lidhur me lartësinë e objekteve, përdorimin e materialeve.
- Shamngja e ndërtimit ose marrja e masave të rrepta mbrojtëse gjatë planifikimit të infrastrukturës turistike dhe objekteve në lokacione që disponojnë me tokë të bonitetit të lartë, pyje, diversitet të konsiderueshëm biologjik, lokacione të pasura me burime ujore që mund të ndikohen drejtëpërdrejtë ose në mënyre indirekte nga aktivitetet e ndërtimit ose funksionimi i objekteve turistike, veçanërisht hotele, restorane, motele, kafene, kampe. Lokacionet e objekteve të planifikuara duhet të jetë brenda kufijve të zonës së përdorimit të qëndrueshëm dhe brezit mbrojtës.